



**UNIVERSITETI “HAXHI ZEKA” PEJË**

**RAPORT**

**MONITORIMI I IMPLEMENTIMIT TË STRATEGJISË PËR PERIUDHËN  
JANAR 2020 – DHJETOR 2020**

Janar 2021

## **Përmbledhje**

Universiteti “Haxhi Zeka” (UHZ) ka hartuar strategjinë e re pesëvjeçare 2020-2024 e cila pasi që është aprovuar ka filluar së zbatuari që nga fillimi i vitit 2020.

Në këtë raport është paraqitur progresi në zbatimin e dokumentit strategjik për vitin 2020. Monitorimi i zbatimit të strategjisë është bërë në baza tremestrale ku komisioni për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit për vitin 2020 ka mbajtur takime duke evidentuar progresin e arritur pas çdo tremujori.

Raporti përmban të dhënat dhe rezultatet nga monitorimi i zbatimit të strategjisë së UHZ-së, dhe përfshinë periudhën kohore Janar – Dhjetor 2020 (shih shtojcën 1)

Monitorimi i zbatimit të planit strategjik është bërë nga Komisioni për Monitorimin e Zbatimit të Strategjisë në mënyrë periodike përgjatë gjithë vitit 2020 dhe përfshinë monitorimin e objektivave strategjike në këto fusha:

1. Menaxhimi dhe administrata
2. Mësimdhënia dhe të mësuarit
3. Sigurimi i Cilësisë
4. Kërkimi shkencor
5. Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe ndër-institucional
6. Studentët
7. Infrastruktura

Në planin strategjik për vitin 2020 ishin të planifikuara gjithsejtë 155 aktivitete të shpërndarë në shtatë fushat strategjike: Menaxhimi dhe administrata (20 aktivitete); Mësimdhënia dhe të mësuarit (26 aktivitete); Sigurimi i Cilësisë (24 aktivitete); Kërkimi shkencor (26 aktivitete); Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe ndër-institucional (15 aktivitete); Studentët (29 aktivitete) dhe Infrastruktura (15 aktivitete)

Nga aktivitetet e planifikuara për vitin 2020, është vërejtur progres në shumicën prej tyre, ndërsa ka edhe aktivitete në të cilat nuk ka pasur progres të mjaftueshëm. Një progres serioz është vërejtur në krijimin dhe funksionalizimi i mekanizmave të rinj brenda universitetit si dhe në plotësimin e infrastrukturës ligjore, duke përfshirë strategjinë pesë vjeçare të UHZ-së, strategjitë në fushat e caktuara strategjike, doracakët dhe kodet e ndryshme. Gjatë vitit 2020 është shënuar progres edhe sa i përket krijimit të komisioneve të ndryshme, hartimit dhe monitorimit të zbatimit të planeve të punës në nivele të ndryshme brenda institucionit. Sigurimit të cilësisë i është kushtuar një kujdes i veçantë, së pari duke i rishikuar rregulloret dhe udhëzuesit për sigurimin e cilësisë, e pastaj duke i zhvilluar dhe zbatuar instrumentet për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë. Edhe në fushën e kërkimit shkencor është shënuar progres gjatë vitit 2020. Përpos hartimit të strategjisë për kërkime shkencore, është vërejtur edhe përparim sa i përket hulumtimeve shkencore si dhe publikimeve të artikujve shkencorë në revista ndërkombëtare. Përkundër problemeve që ka shkaktuar COVID 19, UHZ ka arritur që të organizojë tre konferenca

shkencore dhe gjithashtu të krijojë disa partneritete të reja me universitete ndërkombëtare dhe t'i ripërtërijë disa të tjera. Gjatë vitit 2020 përkundër vështirësive të shkaktuara nga pandemia, UHZ ka qenë aktive në zbatimin e aktiviteteve që ndërlidhen me studentët duke hartuar/publikuar dhe zbatuar “Udhëzuesin për studentë të rinj”, si dhe duke mbajtur sesione këshilluese dhe trajnime për studentët. Gjatë vitit 2020 është shënuar progres edhe sa i përket ofrimit të punës praktike për studentët, përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione publike dhe kompani private. Gjatë vitit 2020 është krijuar gjithashtu rrjeti i ish-studentëve të diplomuar (Alumni) të UHZ-së, ndërsa studentët por edhe dhe “Alumni” janë përfshirë gjatë vlerësimit dhe rishikimit të programeve dhe syllabuseve, si dhe gjatë hartimit të dokumenteve të ndryshme të universitetit. Sa i përket fushës së infrastrukturës, gjatë vitit 2020 është shënuar progres në ndërtimi i infrastrukturës së përshtatshme për personat me nevoja të veçanta, mandej në rregullimi i hapësirave të jashtme, por edhe pajisja me inventar e sallave të përbashkëta të studentëve dhe e korridoreve, rinovimin e disa objekteve si dhe ofrimit të qasjes në internet në hapësirat universitare. Përpos progresit të shënuar gjatë vitit 2020, gjatë monitorimit të zbatimit të strategjisë është vërejtur se ka pasur edhe ngecje në zbatimin e aktiviteteve të planifikuara. COVID 19 dhe gjendja e pandemisë së krijuar gjatë vitit të kaluar, ka pamundësuar zhvillimin e shumë aktiviteteve të planifikuara, sidomos të atyre në të cilat ka qenë e domosdoshme prezenca fizike, qoftë e mësimit apo studentëve. Mobiliteti, pjesëmarrja në konferenca shkencore, vizitat dhe shkëmbimet ndërkombëtare dhe ndëruniversitare, por edhe hulumtimet shkencore të përbashkëta kanë qenë shumë të kufizuara gjatë vitit të kaluar. Aktivitetet e planifikuara për veprimtari dhe krijimtari artistike, në masë të madhe nuk janë realizuar për arsye të COVID 19. Megjithatë, ka pasur edhe aktivitete që me një angazhim më të madh ka pasur mundësi që të realizoheshin. Ngecje më serioze ka pasur në aspektin e mbajtjes së trajnimeve dhe ngritjes së shkathtësive të personelit akademik, personelit administrativë si dhe të studentëve. Programet e trajnimeve të tilla kanë mundur të modifikohen dhe të organizohen “online”. Progres i pamjaftueshëm në fushën e kërkimit shkencor është vërejtur në realizimin e aktiviteteve që ndërlidhen me themelimin dhe funksionalizimi e “Instituteve Hulumtuese” në nivel universiteti dhe në nivel të njësive akademik. Progres i pamjaftueshëm është vërejtur edhe sa i përket ofrimit të hapësirave të përshtatshme për aktivitetet e studentëve.

Në përgjithësi, mund të thuhet se monitorimi i zbatimit të planit strategjik për vitin 2020 ka treguar se mobilizimi i përgjithshëm të UHZ-së ka rezultuar me sukses duke rikthyer akreditimin në nivel të institucionit. Planin strategjik i ri i cili ka filluar së zbatuari në vitin 2020 i adreson sfidat dhe duhet të përdoret si udhërrëfyes për të shfrytëzuar përparësitë dhe mundësitë e zhvillimit të suksesshëm të këtij Institucioni publik.

## **Hyrje**

Universiteti “Haxhi Zeka në Pejë që nga fillimi i vitit 2020 është duke zbatuar Strategjinë zhvillimore për periudhën 2020-2024 e cila ishte aprovuar në fillim të vitit 2020 me objektiva

strategjike për menaxhim dhe administratë efikase, transparente dhe llogaridhënëse; mësimdhënie cilësore me metoda e teknologji bashkëkohore dhe programe atraktive; sistem i konsoliduar i sigurimit të cilësisë në përputhje me standardet ndërkombëtare; veprimtari kërkimore dhe krijimtari artistike cilësore që i kontribuon zhvillimit të shoqërisë; bashkëpunim intensiv ndërkombëtar dhe ndër-institucional; shërbime dhe aktivitete të shumta e cilësore për studentët dhe infrastrukturë e mjaftueshme, bashkëkohore dhe e mirë-pajisur.

Ky raport përfshinë rezultatet nga monitorimi i zbatimit të strategjisë përgjatë vitit 2020 të cilat kanë të bëjnë me:

- Vlerësimet rreth përmbushjes së objektivave nga fillimi deri në fund të vitit 2020
- Përcaktimin e prioriteteve kryesore për vitin e ardhshëm

Procesi i rishikimit të zbatimit të strategjisë për vitin 1 ka përfshirë:

- Takimet me Komisionin e emëruar për monitorimin e zbatimit të strategjisë së Universitetit “Haxhi Zeka”
- Grumbullimin e të dhënave nga të gjitha njësitë akademike dhe organet drejtuese të Universitetit rreth zbatimit të aktiviteteve nga plani strategjik për vitin 2020
- Krahasimi i të dhënave të grumbulluara me aktivitetet e planifikuara për vitin 2020

## **Konteksti**

Në planin strategjik të veprimit për vitin 2020 ishin përcaktuar aktivitetet sipas objektivave strategjike përmes të cilave UHZ do të realizonte më së miri misionin e tij.

Në verën e vitit 2019, UHZ kishte dështuar që të akreditohej në nivel institucional, përkundër akreditimit të shumicës së programeve studimore. Institucioni ishte mobilizuar që të përgatitej dhe ta rikthente akreditimin institucional dhe në kuadër të shumë aktiviteteve gjatë vitit 2019 ishte edhe hartimi i planit të ri strategjik, 2020-2024.

Ky raport merr në konsideratë aspektet që kanë të bëjnë me monitorimin e zbatimit të aktiviteteve gjatë vitit 2020.

## **Progresi i arritur gjatë vitit 2020**

Plani strategjik i veprimit për vitin 2020 i numëron shtatë objektiva strategjike në kuadër të së cilave janë shumë nën-objektiva të tjera. Objektivat bazë për vitin 2020 ishin po ato objektiva, të cilat i përmbante strategjia pesë vjeçare e UHZ-së. Progresi i arritur gjatë vitit 2020 është paraqitur sipas shtatë objektivave strategjike

Në kuadër të objektivave dhe nën objektivave strategjike, plani i veprimit për vitin 2020 numëronte rreth 155 aktivitete/projekte për tu realizuar përgjatë vitit 2020. Të dhënat nga

monitorimi tregojnë se është arritur progres në shumicën e aktivitetet të planifikuara. Përditësimet e detajuara për progresin sipas objektivave janë paraqitur në shtojcën e këtij raporti

Përshkrimi i progresit në zbatimin e aktivitetet kryesore të ndërmarra sipas planit të veprimit për vitin 2020 është paraqitur pas monitorimit periodik të zbatimit të aktiviteve të planifikuara për secilën fushë strategjike.

## **Menaxhimi dhe administrata**

Objektivi strategjik në këtë fushë ishte “Menaxhim dhe administratë efikase, transparente dhe llogaridhënëse”. Për vitin 2021, qenë planifikuar 20 aktiviteve në këtë fushë strategjike.

Nga aktivitetet e planifikuara është vërejtur progresi në gjashtëmbëdhjetë prej tyre, në dy kishte progres të përsëritshëm ndërsa në dy aktivite nuk është vërejtur se ka pasur progres. Në lidhje me krijimin dhe funksionalizimi i mekanizmave të rinj brenda universitetit është vërejtur se ZPM është funksionale (e përbashkët me zyrën për çështje akademike), ZSC dhe ZKSH dhe ZBN janë funksionale. “Qendra për Inovacion” dhe “Qendra nga teoria në praktikë” janë në proces të krijimit dhe të funksionalizimit. Është punuar në plotësimin e rregulloreve, kodeve, strategjive sektoriale, dhe doracakëve, ndërsa gjatë vitit 2021 do të përfundohen edhe rregulloret e mbetura. Vërehet se i është kushtuar kujdes hartimit të planeve vjetore të punës dhe plotësimit dhe përditësimit të web faqes zyrtare. Ngecje është vërejtur në zbatimin e aktiviteve të planifikuara të cilat ndërlidhen me trajnimet për stafin udhëheqës dhe administrativ me qëllim të rritjes së profesionalizmit dhe efikasitetit të shërbimeve. COVID- 19 ka ndikuar që aktivitetet e parapara për trajnime të mos realizohen

## **Mësimdhënia dhe të mësuarit**

Kjo fushë ka si objektivi strategjik “mësimdhënien cilësore me metoda e teknologji bashkëkohore dhe programe atraktive”. Për vitin 2020 ishin planifikuar 26 aktivitetet dhe në shumicën e tyre është shënuar progres, por janë disa aktivite në të cilat nuk ka pasur përparim të mjaftueshëm. Aktivitetet në të cilat ishte planifikuar punësimi, avancimi dhe përkrahja e personelit të sapo punësuar akademik, janë zbatuar gjatë vitit 2020. Aspekti gjinor është përfillur gjatë punësimit të stafit akademik. Gjatë vitit 2020 është rishikuar “Kodi i Etikës” dhe janë rishikua rregulloret për studime në dy nivele, Bachelor dhe Master. Gjatë vitit 2020 është publikuar orari i konsultimeve me studentë, është themeluar zyra për përsosmëri në mësimdhënie, është krijuar “Ekipi për zhvillim profesional”, si dhe janë krijuar komisionet për mësimdhënie dhe mësim nxënie. Aktivitetet e planifikuara në këtë fushë, në të cilat kishte ngecje ishin aktivitetet që ndërlidhen me: Monitorimi i zbatimit të metodave bashkëkohore të mësimdhënies dhe të vlerësimit përmes monitorimit” (mësimdhënies në praktikë); Realizimi i vizitave studimore në universitete perëndimore (janë realizuar vetëm disa të tilla në tremujorin e parë të vitit 2020 në tremujorët e

tjerë nuk kishte për arsye të COVID 19). Edhe te aktiviteti i planifikuar për fuqizimin e sistemit tutorial kishte më pak angazhim për arsye të COVID 19). Gjatë vitit 2020 është krijuar qasja në disa “databaza” elektronike, ndërsa bibliotekat janë pasuruar me disa ekzemplarë të librave, por këtu do të duhej të kishte më shumë progres. Progresi ka munguar edhe sa i përket publikimit të librave universitarë. Një aktivitet i cili ka mbetur pa u zbatuar gjatë vitit 2020 ka të bëjë me zhvillimi i shkathtësive kompjuterike dhe teknologjike të stafit akademik. Përkundër faktit se ishin identifikuar disa mësimdhënës, trajnimet nuk kanë filluar gjatë vitit 2020. UHZ nuk kishte sukses për akreditimin e programit PhD, ndërsa janë në proces të akreditimit disa programe studimore në nivelin Master. Gjatë vitit 2020 janë rishikuar të gjitha programet e studimeve si dhe syllabuset e lëndëve.

## **Sigurimi i cilësisë**

Objektivi strategjik në fushën e sigurimi të cilësisë është “Sistem i konsoliduar i sigurimit të cilësisë në përputhje me standardet ndërkombëtare”. Gjatë vitit 2020 në këtë fushë strategjike qenë planifikuar njëzet e katër aktivitete. Në shumicën e aktiviteteve është shënuar një progres i theksuar. Janë hartuar, rishikuar dhe miratuar rregullorja e re për Sigurim të Cilësisë (SC), Strategjia për Sigurim të Cilësisë (SC) si dhe udhëzuesit për Sigurim të Cilësisë (SC). Gjatë vitit 2020 është hartuar manualit për vlerësimin e performancës së programeve të studimit dhe është krijuar Zyra për Sigurim të Cilësisë (ZSC) në nivel universiteti ndërsa janë funksionalizuar edhe Zyrat e Koordinatorëve të Cilësisë (ZKC) në nivel të njësive akademike. ZSC gjatë vitit 2020 ka bërë vlerësimin e cilësisë duke përdorë instrumentet e zhvilluara për vlerësimin e sigurimit të cilësisë. Raportet për vlerësimin e cilësisë janë përfunduar dhe publikuar. Gjatë vitit 2020 është bërë hartimi dhe miratimi i manualit për vlerësimin e performancës së stafit akademik, hartimi i “Planit për Zhvillimin e Stafit Akademik” si dhe hartimi dhe publikimi i manualit për studentë. Edhe në këtë fushë strategjike ka pasur ngecje në zbatimin e disa aktiviteteve. Progresi ka munguar në katër aktivitete të planifikuara siç është trajnimi i stafit përgjegjës për Sigurim të Cilësisë (SC) i cili nuk është kryer për stafin e Zyrës për Sigurim të Cilësisë (ZSC) në nivel universiteti dhe stafin e Zyrave të Koordinatorëve të Cilësisë (ZKC) në nivel të njësive akademike/fakulteteve. Integrimi i modulit për të dhëna dhe statistika në kuadër të SEMS-it gjithashtu nuk është funksionalizuar dhe nuk është arritur administrimi i të gjithë pyetësorëve, përkatësisht mbledhja e të dhënave dhe përpunimi i këtyre pyetësorë në mënyrë elektronike përmes sistemit SEMS. Nuk ka filluar gjithashtu trajnimi i stafit për përpunim dhe raportim të dhënave dhe statistikave.

## **Kërkimi shkencor**

Objektivi strategjik në këtë fushë është “Veprimtari kërkimore dhe krijimtari artistike cilësore që i kontribuon zhvillimit të shoqërisë”. Janë gjithsejtë njëzet e gjashtë aktivitete të planifikuara në këtë fushë strategjike. Gjatë vitit 2020 është krijuar Zyra për Kërkime Shkencore (ZKSH) në nivel

universiteti, është hartuar Strategjia për Kërkime Shkencore dhe është bërë ndarja e buxhetit të veçantë për kërkime shkencore. Gjatë vitit stafi akademik ka hartuar projekte hulumtuese dhe disa prej tyre janë miratuar, ndërsa janë realizuar hulumtime në bashkëpunim me universitetet/kolegët ndërkombëtarë dhe me universitetet/kolegët vendorë. Nuk kanë munguar edhe hulumtimet në bashkëpunim me kolegët nga brenda UHZ. Një numër i studentëve është përfshirë në hulumtime shkencore. Një numër i stafit akademik është trajnuar për përgatitjen e publikimeve, ndërsa stafi akademik është përkrahur për publikime në revista shkencore ndërkombëtare. Pjesëmarrja e stafit akademik në konferenca ndërkombëtare gjatë vitit 2020 ishte e ulët për arsye të COVID 19. Gjatë vitit 2020, UHZ ka realizuar tre konferenca shkencore. Aktivitetet e planifikuara për veprimtari dhe krijimtari artistike, në masë të madhe nuk janë realizuar për arsye të COVID 19, prandaj shumë nga këto aktivitete janë shtyrë për vitin 2021. Progres i pamjaftueshëm në fushën e kërkimit shkencor është vërejtur në realizimin e aktiviteteve që ndërlidhen me themelimin dhe funksionalizimi i Instituteve hulumtuese në nivel universiteti dhe në nivel të njësive akademike. Progresi ka munguar edhe sa i përket realizimit të trajnimeve nga ekspertë ndërkombëtarë për hartimin e projekteve hulumtuese që ka rezultuar me mos zbatimin edhe të aktiviteteve që ndërlidhen me organizimin e trajnimeve nga stafi i brendshëm i UHZ-së. Progres nuk ka pasur edhe në realizimin i hulumtimeve aplikative.

### **Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe ndër-institucional**

Në vitin 2020 qenë planifikuar 15 aktivitete në funksion të realizimit të objektivit strategjik “Bashkëpunim intensiv ndërkombëtar dhe ndër-institucional”. Gjatë vitit të kaluar është hartuar dhe miratuar “Strategjisë për Bashkëpunim Ndërkombëtar” si dhe është krijuar Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar (ZBN) në nivel universiteti. Për vitin 2020 qe ndarë një buxhet i veçantë për bashkëpunim ndërkombëtar por për arsye të COVID 19 ka mbetur në masë të madhe i pa shfrytëzuar. Gjatë vitit 2020 përkundër pandemisë UHZ ka arritur që të krijojë disa partneritete të reja me universitete ndërkombëtare dhe t’i ripërtërijë disa të tjera. Për arsye të COVID 19, vetëm pjesërisht është arritur një progres sa i përket hulumtimeve të përbashkëta me kolegë/universitete ndërkombëtare si dhe mobilitetit ndërkombëtar të stafit akademik dhe të studentëve. UHZ, gjatë vitit 2020 ishte e përfshirë në realizim e disa projekteve të përbashkëta ndërkombëtare si dhe në zhvillimin e programeve të përbashkëta të studimeve me universitete vendore e ndërkombëtare. Bashkëpunimi me institucione e biznese për harmonizimin e programeve me kërkesat dhe nevojat e tregut të punës është vërejtur në fakultetin e turizmit. Ngecje është vërejtur në punësimin/avancimin e stafit në Zyrën për Bashkëpunim Ndërkombëtar si dhe në trajnimin e tyre për bashkëpunim ndërkombëtar dhe ndër-institucional. Nuk është vërejtur progres edhe në krijimin i Qendrës për Inovacione dhe Përkrahje të Biznesit (QIPB). Për arsye të COVID 19 ka dështuar edhe organizimi i Universitetit Veror Ndërkombëtar i UHZ-së.

Progres i pa mjaftueshëm është vërejtur edhe sa i përket Bashkëpunimi me institucione e biznese për praktikën e studentëve.

## **Studentët**

Objektivi strategjik në këtë fushë është “Shërbime dhe aktivitete të shumta e cilësore për studentët” dhe në funksion të realizimit të këtij objektivi, për vitin 2020 ishin planifikuar njëzet e nëntë aktivitete. Qendra për Zhvillimi të Karrierës (QZHK) në bashkëpunim me Zyrën për Komunikim dhe Informim e UHZ-së, ka vazhduar bashkëpunimin me shkollat e mesme të larta të komunave të rajonit të Pejës, ndërsa në kohën e regjistrimit të studentëve të rinj, UHZ ka organizuar “Ditët e Hapura” për studentët potencialë duke organizuar të vizita informuese dhe shpërndarjes të materialeve për promovim. Gjatë vitit 2020 është hartuar/publikuar dhe ka filluar të zbatohet Udhëzuesi për studentë të rinj. Prezantimi është bërë gjatë javës së mirëseardhjes. Gjatë vitit 2020 vazhdimisht është analizuar kalueshmëria e studentëve (e cila ishte 50.9%) dhe nuk ka pasur raste të studentëve kopjues. Ka pasur sesione këshilluese dhe trajnime për studentët e UHZ-së dhe trajnime sesioni këshillimi individual dhe janë organizuar disa trajnime si në: Menaxhimi i karrierës, Përgatitja e dokumentacionit për aplikim për punë, Trajnimin Përgatitor për Punësim dhe Shkollim, Shkathtësitë e prezantimit, Trajnim për ndërmarrësi, Të drejtat e njeriut dhe e drejta e punës dhe të rinjtë/punësimi dhe integrimi Evropian, Të drejtat e njeriut dhe e drejta e punës, Të rinjtë/punësimi dhe integrimi Evropian, Trajnim për ndërmarrësi, Shkathtësitë e prezantimit, Përgatitja e CV-së dhe Letrës së Motivimit. Gjithashtu janë mbajtur disa diskutime dhe ligjërata. UHZ ka vazhduar me praktikën e “sistemit tutorial”, përmes së cilit studentët janë përkrahur nga “studentët tutorë” sipas parimit të përkrahjes “shoku-shokut” Gjatë vitit 2020 është shënuar progres edhe sa i përket ofrimi i punës praktike për studentët përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit institucionet e kompanitë e interesuara për ofrimin e punës praktike për studentët. Plani vjetor dhe buxheti për aktivitetet e studentëve është hartuar dhe miratuar. Sa i përket organizimit të aktiviteteve edukative, artistike, kulturore, sociale, sportive e rekreative për/nga studentët e UHZ-së, për arsye të COVID 19 kishte pak progres dhe shumë aktivitete të planifikuar janë shtyrë. Është krijuar rrjeti ish-studentëve të diplomuar (Alumni) të UHZ-së. Studentët dhe “Alumni” janë përfshirë gjatë vlerësimit dhe rishikimit të programeve dhe syllabuseve, si dhe në hartimin e dokumenteve të ndryshme të universitetit. Organizimi i takimit vjetor me “Alumni” dhe ndarja e mirënjohjeve për “Alumni” që i kontribuojnë UHZ-së nuk është bërë për arsye të COVID 19 dhe është shtyrë për më vonë. Mobiliteti i studentëve gjatë vitit 2020 ishte i ulët për arsye të COVID 19, ndërsa edhe organizimi i “Panairit të Karrierës” nuk është mbajtur për arsye të COVID 19. Progres i pamjaftueshëm është vërejtur sa i përket ofrimit të hapësirave të përshtatshme për aktivitetet e studentëve. Disa aktivitete siç ishin: Organizimi i Konferencës Rajonale Shkencore të Studentëve si dhe pjesëmarrja e studentëve në gara ndërkombëtare janë shtyrë për arsye të COVID 19.



## **Infrastruktura**

Objektivi strategjik në fushën e infrastrukturës është “Infrastrukturë e mjaftueshme, bashkëkohore dhe e mirë-pajisur”. Për vitin 2020 për këtë fushë strategjike ishin të planifikuara pesëmbëdhjetë aktivitete. Vetëm në disa prej tyre është vërejtur progres ndërsa ka disa aktivitete në të cilat progresi ishte i pa mjaftueshëm ose aktivitetet nuk kanë filluar fare së zbatuari. Progres edhe pse jo i mjaftueshëm është vërejtur në ndërtimin e fakultetit të arteve. Gjatë vitit 2020 është punuar në ndërtimin e këtij fakulteti por nuk është arritur që të përfundohet ashtu siç ishte paraparë. Gjatë vitit 2020 është përfunduar me sukses ndërtimi i infrastrukturës së përshtatshme për personat me nevoja të veçanta. Është punuar gjithashtu në rregullimi i hapësirave të jashtme, sidomos të parqeve para objekteve. Progres është vërejtur në pajisjen e sallave të përbashkëta të studentëve dhe e korridoreve, si dhe në rinovimin e disa objekteve si dhe ofrimin të qasjes në internet në hapësirat universitare. Progres është shënuar edhe sa i përket pajisjes së kabineteve të informatikës. Ka pasur progres në pajisjen e sallave të ligjëratave dhe riorganizimin e inventarit. Është përfunduar edhe aktiviteti që ndërlidhet me pajisja me rekuizita dhe instrumente të Fakultetit të Arteve (FA). Për shkak të vonesës në ndërtimin e fakultetit të arteve, nuk është realizuar edhe aktiviteti për krijimin e hapësirave të tjera për stafin dhe studentët. Nuk ka pasur progres në realizimin e aktivitetit që ndërlidhet me pajisjen e zyrave të stafit. Ndërtimi i fakultetit të biznesit nuk ka filluar së ndërtuari.

## **Mjedisi i jashtëm**

Megenëse gjatë vitit 2019, UHZ kishte dështuar që të akreditohej në nivelin institucional, institucioni ishte mobilizuar në përmbushjen e standardeve për institucionet e arsimit të lartë që ndërlidhen me mësimdhënien, hulumtimin, sigurimin e cilësisë bashkëpunimin ndër institucional dhe ndërkombëtar etj. UHZ kishte vazhduar edhe gjatë vitit 2020 që të përgatitej maksimalisht për tu akredituar në nivelin institucional por edhe për akreditimin dhe ri-akreditimin e programeve studimore të cilat janë në funksion të edukimit dhe punësimit të rinjve. UHZ në vitin 2020 ka arritur që me sukses ta rikthejë akreditimin institucional dhe të akreditojë e ri akreditojë shumicën e programeve studimore në nivelin Bachelor dhe Master

UHZ, ashtu si edhe institucionet e tjera publike të arsimit të lartë ka vazhduar që edhe gjatë vitit 2020 të varet nga buxheti i shtetit.

Kapacitetet e stafit akademik por edhe të administratës në institucionet publike mbeten të kufizuara ndërsa sfidë në vete mbeten investimet në infrastrukturë siç janë p.sh. laboratorët, hapësirat për personelin akademik, mensat, kampet sportive etj.

Lëvizja e lirë brenda kufijve të Evropës mbetet akoma e pa realizuar duke kufizuar mundësitë e punësimit jashtë vendit të rinjve kosovarë por edhe të studentëve që përfundojnë studimet në UHZ. Megjithatë, ka shpresë që në të ardhmen të krijohet mundësia e lëvizjes së lirë, prandaj,

është me rëndësi që sistemi i arsimit në Kosovë duke përfshirë edhe UHZ-në, t'i përshtatet kërkesave të tregut evropian të punës përmes ngritjes së cilësisë së studimeve.

Si përfundim mund të thuhet se mjedisi i jashtëm edhe gjatë vitit 2020, ka vazhduar të ofrojë disa mundësi siç është rritja e lehtë e buxhetit, por në anën tjetër rritja e papunësisë në vend, pamundësia e lëvizjes së lirë si dhe ulja demografike, mund të reflektojnë në të ardhmen edhe në uljen e interesimit të rinjve për të ndjekur studimet e larta.

## **Prioritetet afatshkurtra**

UHZ së gjatë vitit 2020 ka filluar që ta zbatojë Strategjinë pesë vjeçare (2020-2024) me objektiva të qarta dhe shumë të rëndësishme për perspektiven e Institucionit. Pas rikthimit të akreditimit në nivel institucional, prioriteti kryesor i UHZ-së mbetet zbatimi i objektivave të strategjisë.

Të dhënat e grumbulluara rreth realizimit të aktiviteteve gjatë vitit 2020 tregojnë se përkundër progresit të arritur në të gjitha fushat strategjike, fokusi I përpjekjeve në afatin e shkurtër do të vazhdojë që të jetë në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies përkundër disa arritjeve në këtë aspekt, ndërsa prioriteti tjetër do të jetë puna hulumtuese shkencore e studentëve dhe e personelit akademik në projekte të ndryshme hulumtuese shkencore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Bashkëpunimi me sektorin privat dhe projektet e përbashkëta në të mirë të studentëve dhe komunitetit do të duhej të ishin prioritet i vazhdueshëm i UHZ-së. Pandemia e cila ka vazhduar përgjatë gjithë vitit 2020 ka bërë që shumë aktivitete të planifikuara të mbeten të pa zbatuara. Prandaj, UHZ gjatë zhvillimit të planit të veprimit për vitin 2021 do të duhej të konsideronte ndikimin që mund të ketë COVID 19 në aktivitetet e planifikuara për vitin 2021. Do të ishte mirë që për vitin 2021 të planifikoheshin më shumë aktivitete të cilat në mënyrë alternative do të mund të zbatoheshin në formën “online” për të ulur kështu efektin negativ të COVID 19.

## **Prioritetet afatgjata**

UHZ është duke vazhduar me kompletimin e infrastrukturës në mënyrë që kampusi universitar të veprojë me tërë kapacitetin e tij. Gjatë vitit 2020 nuk është vërejtur ndonjë progres i theksuar sa i përket kompletimit të infrastrukturës, prandaj do të ishte mirë që UHZ ta konsiderojë çështjen e infrastrukturës me më shumë prioritet. Te gjeturat nga monitorimi i zbatimit të planit strategjik për vitin 2020 tregojnë se UHZ është duke vazhduar që të konsolidojë programet dhe profilet aktuale studimore, por është e nevojshme që të planifikojë edhe zhvillimin e programeve të reja dhe shërbimeve të tjera që janë në funksion të zhvillimit të Pejës, Regjionit dhe të vendit në përgjithësi.

## **Përfundimet**

Si përfundim nga monitorimi i zbatimit të planit strategjik për vitin 2020, mund të thuhet se UHZ ka avancuar në zbatimin e aktiviteteve në shumicën e fushave strategjike të planifikuara me planin e ri strategjik pesë vjeçar, por është vërejtur se ka ngecje në aspektin e mbajtjes së trajnimeve dhe ngritjes së shkathtësive të personelit akademik, personelit administrativë si dhe të studentëve. Progres i pamjaftueshëm është vërejtur në realizimin e aktiviteteve që ndërlidhen me themelimin dhe funksionalizimi e “Instituteve Hulumtuese” në nivel universiteti dhe në nivel të njësive akademik.

Prof. Asoc. Dr. Agim Rysha

Kryetar i Komisionit për Monitorimin e Zbatimit të Strategjisë